



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**

KPK/Nr. 277/2022  
Datë: 15 shkurt 2022

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 7 paragrafi 7 të Rregullores Nr. 06/2019 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, në takimin e mbajtur më datë 15 shkurt 2022, nxjerr këtë:

**VENDIM**

- I. Konfirmohet statusi i kandidatëve të cilët i kanë plotësuar kriteret për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit, si në vijim:
  1. Arben Ismajli, prokuror në Prokurorinë e Apelit të Kosovës;
  2. Armend Hamiti, prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë;
  3. Blerim Isufaj, Kryeprokuror në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës;
  4. Kujtim Munishi, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë;
  5. Lulzim Sulejmani, prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit; dhe
  6. Shqipdon Fazliu, prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.
  
- II. Obligohet Sekretariati që t'i njoftojë kandidatët e cekur në paragrafin I të këtij Vendimi si dhe këtë Vendim ta publikojë në ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
  
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Jetish Maloku  
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Sekretariatit të KPK-së;
- Arkivit të KPK-së.